



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 22.4.2023

Nr: 398

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË TELEVIZIONEVE “STAR PLUS”, “SYRI TV”, “KLAN TV” DHE  
MEDIA ONLINE “ALBANIAN POST”, PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E  
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot në datën 22.4.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesat me:

- KËRKUES:** Televizioni “Star Plus”, me adresë Rruga “Kolë Idromeno”, Shkodër, dhe me përfaqësues z. Senad Nikshiqi,  
Televizioni “Syri TV”, me seli në Tiranë dhe me përfaqësues z. Gazmir Spahija,  
Televizioni “Klan TV”, me adresë Rruga “Aleksander Moisiu”, Nr. 97, Tiranë, dhe me përfaqësues zj. Eglantina Lamaj,  
Media Online “Albanian Post”, me seli në Tiranë dhe me përfaqësues zj. Gerta Zaimi,
- OBJEKTI:** Kërkohet akreditimi i përfaqësuesve të medias për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
- BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”.

Data: 22.4.2023 Nr: 398  
Ora: 12:00



Për shqyrtimin e kërkesave të televizioneve “Star Plus”, “Syri Tv”, “Klan Tv” dhe media on line “Albanian Post”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”

## V Ë R E J:

Televizioni “Star Plus” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 13 (trembëdhjetë) gazetarë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Televizioni “Star Plus” është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Televizioni “Syri TV” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 58 (pesëdhjetë e tetë) gazetarë, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Televizioni “Syri TV” është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Televizioni “Klan TV” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 68 (gjashtëdhjetë e tetë) gazetarë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Televizioni “Klan TV” është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Media Online “Albanian Post” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 7 (shtatë) gazetarë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Media Online “Albanian Post” është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

## P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të neneve 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”,

## V E N D O S:

1. Akreditimin e 13 (trembëdhjetë) gazetarëve të televizionit “Star Plus”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Akreditimin e 58 (pesëdhjetë e tetë) gazetarëve të televizionit “Syri TV”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Akreditimin e 68 (gjashtëdhjetë e tetë) gazetarëve të televizionit “Klan TV”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Akreditimin e 7 (shtatë) gazetarëve të medias online “Albanian Post”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

